

Për gjenezën e këngëve tona popullore historike

Mark Krasniqi

GJURMAVE TË NJË KËNGE POPULLORE

— KËNGA E HASIMES —

Në thesarin e pasur të poezisë popullore shqiptare një vend i rëndësishëm u takon këngëve të trimërisë, sepse këto paraqiten në dimensione të mëdha për kah numri dhe në një shkallë të lartë për kah kualiteti artistik. Këto karakteristika të përgjithshme të këtij lloji të këngëve popullore kanë rrënjët e tyre në shpirtin poetik të popullit, në aftësitë e tij krijuese, por gjithashtu edhe në motivin që shtjellohet në trimërinë, që ka luajtur rol shumë të madh jo vetëm në historinë tonë kombëtare në përgjithësi, por edhe në rrethin më të ngushtë të jetës, në marrëdhëniet e përditshme, sidomos në fshat. Lutta shekullore e popullit tonë për ekzistencë nuk është shënuar vetëm në faqet e historisë. Ajo gjithmonë ka pasur një dëshimtar të gjallë, poetin popullor, i cili e ka përcjellë këtë luftë me kujdes dhe e ka bërë të pavdekshme, duke e përshkruar në këngët historike.

Kushtet shoqërore historike, ato ekonomike, shkalla e kulturës së përgjithshme, e sidomos organizimi fisnor, në të kaluarën e popullit tonë kanë krijuar një atmosferë të posaçme në jetën shoqërore dhe individuale, kanë potencuar në mënyrë të dukshme disa faktorë, disa elemente, të cilat janë bërë kategori etnike të tij. Ndër këto më të dalluarat janë: besa, burrëria dhe trimëria. Në të vërtetë të gjitha këto, dhe një varg kategorish të tjera etnike, mund të shprehën vetëm me fjalën „burrëria”. „Burri” shqiptar duhej të ishte besnik, trim, mikpritës, i sinqertë etj. Po t’i mungonte vetëm njëra nga këto veti pozitive (dhe nga disa të tjera) ai nuk çmohej „burrë” në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Trimëria pra, ishte një nga elementet kryesore që e dallonte shqiptarin. Kuptohet se këto karakteristika kanë qenë prezente edhe ndër popujt e tjerë ballkanikë në rrethanat e njëjta ose të ngjashme shoqërore me ato në të cilat ka jetuar populli ynë.

Mirëpo, në kuadrin e kuptimit më të gjerë të trimërisë përfshiheshin edhe disa elemente të tjerë që nuk kanë të bëjnë shpeshherë me trimërinë e vërtetë, si për shembull hakmarrja. Themi se hakmarrja nuk është trimëri sepse, para se gjithash, ajo është një vepër kriminale me të cilën i merret jeta një individi që, për fajin e vet, duhet të pësojë ndeshkimin e institucioneve përkatëse shtetërore, ose të atyre shoqërore dhe fisnore (në të kaluarën) e jo të ndeshkohet me vdekje nga një individ. Nga ana tjetër, sipas dispozitave të Kanunit dhe të botëkuptimit të një shoqërie patriarkale, hakmarrja zbatohet shpeshherë jo kundër dorasit, por kundër një individi tjetër që ishte nga vëllazëria ose dhe nga fisi i tij. Pra, hakmarrja shpeshherë kërkonte edhe viktima fare të pafajshme. Nga ana tjetër, hakmarrja kryhej në mes të anëtarëve të një ose dy fiseve, pra brenda një populli, kështu që kjo ishte vëllavrasje, e kurrsesi trimëri. Në të vërtetë hakmarrja dobësonte popullin tonë në luftën e tij kundër armikut të jashtëm. Përveç kësaj, edhe një aspekt tjetër ia mohon bindshëm hakmarrjes atributin e trimërisë. Hakmarrja zakonisht kryhet tinëzisht, nga prita, madje edhe duke paguar një person tjetër që ta kryejë krimin. Trimi i vërtetë, përkundrazi, i del armikut përballë. Madje trimi i traditës shqiptare donte që edhe kundërshtari i tij, në momentin kritik, të kishte të njëjtat kushte — të ishte i armatosur, i përgatitur për një aksion të këtillë dhe të kishte rast të tregojë edhe ai trimërinë e tij. Vetëm në këtë mënyrë mund t'i takonte oreoli i trimërisë së vërtetë fituesit. Hakmarrja nuk është kryer zakonisht në këto kushte, përveç rasteve të rralla. Ajo nuk është bërë nga motivacione të larta, siç janë liria, pavarësia, barazia kombëtare, revolucioni shoqëror etj., por përkundrazi, ka qenë fryt i instinkteve të ulëta vehtjake.

Disa autorë të huaj mendojnë se hakmarrja është një nga karakteristikat etnike të popullit shqiptar. Shumë nga këta e kanë thënë dhe e thonë këtë të pavërtetë në shkrimet e tyre edhe atëherë kur e dinë se gënjejnë. Mirëpo kjo u hynte në punë, siç mendonin ata, për të na paraqitur para botës si popull që ende është larg qytetërimit (e kjo pastaj duhej të kishte edhe pasojat e veta). Hakmarrja në të vërtetë nuk është pjellë e një populli, e një grupi etnik, ose e një kombi. Ajo është prodhim i kushteve shoqërore-historike të një ambienti të caktuar gjeografik. Prandaj, në shkallën e caktuar të zhvillimit shoqëror dhe në kushte të caktuara historike e kulturore hakmarrja ka qenë prezente te shumë popuj, te shumë grupe etnike ose në shumë ambiente gjeografike. Në robërinë shekullore osmane, kur pushteti shpeshherë ishte shumë i dobët, madje në viset malore as që arrinte fare, në kohën e anarkizmit dhe të kapadaillëkut, hakmarrja lindi si një masë e mbrojtjes personale dhe të pasurisë. Ajo zuri vend edhe në kodin penal të shoqërisë fisnore dhe u rrënjos edhe në psikologjinë e njerëzve me tradita patriarkale. Ai që nuk i merrte gjakun vëllait, ose anëtarit nga fisi i tij, përbufej nga rrethi i tij dhe pësonte poshtërime të çdo lloji. Ai nuk kishte vend ndër burra, zëri i tij nuk dëgjohej, ishte si njeri i leçitur nga shoqëria. Madje në

shtëpi të huaj, atij i jipej filxhani i kafes në mënyrë poshtëruese-duke e mbajtur dorën me filxhan nën nivelin e gjurit dhe duke mos e vënë dorën e majtë në zemër, siç është zakoni në çdo rast tjetër.

Kur u zhdukën rrethanat historike shoqërore që cytnin hakmarrjen, kur u ndërrua sistemi shoqëror (sidomos pas Luftës së Dytë Botërore me vendosjen e rendit socialist në Shqipëri dhe në Jugosllavi), iu prenë rrënjët edhe hakmarrjes. Ajo në RP të Shqipërisë u zhduk fare, ndërsa ndër shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e në Mal të Zi paraqitet shumë rrallë.

Nga ana tjetër, në të kaluarën, hakmarrësi ishte i nderuar nga rrethi i tij. Ai që bënte këtë krim, para syve të një bote patriarkale të ngarkuar me paragjykime të rënda, ishte njeri që me pushkën e tij „ia zbardhi fytyrën familjes edhe mbarë fisit”. Ai shpeshherë ishte madje edhe një „trim”, të cilit i këndohej kënga. Kur këtë gjest në raste shumë të rralla, e kryente gruaja, kjo „trimëri” peshonte edhe më tepër dhe ishte një ngjarje e jashtëzakonshme rreth së cilës thureshin kallëzime dhe këngë me stërmadhime mbi „virtytet e heroinës”. Një rast të këtillë, i njohur mjaft mirë edhe në masat e gjëra të popullit, ndonëse nga kjo ngjarje ka kaluar më se një gjysmë shekulli, është dhe hakmarrja që bën Hasimja, e cila, aty kah viti 1925, e mbetur e vejë dhe pa mashkull në shtëpi, ua merr gjakun dy vëllezërve të vet, duke vrarë „Xhem Mirashin me gjith të vllanë”.

Mbi këtë ngjarje të hidhur ekziston një këngë e bukur popullore, e cila është mjaft e popullarizuar, madje më shumë në viset e Rrafshit të Dukagjinit, se sa në fshatin Mirash afër Prishtinës, ku ndodhi ky rast i jashtëzakonshëm i hakmarrjes. Nëse e kuptojmë hakmarrjen si produkt të shkallës së ulët të vetëdijes shoqërore, e cila është e kushtëzuar nga baza materiale dhe rrethanat e tjera historiko-shoqërore në një ambient gjeografik dhe, nëse përqëndrojmë vëmendjen vetëm në anën estetike dhe fuqinë shprehëse të poetit popullor që ka thurë këngën e Hasimes, do të shohim se këtu kemi të bëjmë me njërin nga shembujt më të bukur të krijimtarisë popullore. Hasimja si protagoniste e rrallë ngjarjesh të këtilla, në vargjet e poetit popullor është heroinë, megjithëse ajo në realitet nuk bën një vepër heroike, por vetëm një krim të ri, duke luftuar kundër një krimi që kishte ngjarë disa vjet më parë. Mirëpo, ajo është rritur dhe është formuar në një rreth dhe në një kohë të caktuar, kur protagonistët e këtillë kanë qenë plotësisht të bindur se duke kryer hakmarrjen nuk bëjnë as më të vogëlin faj, përkundrazi, kryejnë një detyrë „të shejtë”, një obligim ndaj viktimes së mëparshme, ndaj familjes së tij, madje dhe ndaj shoqërisë, ndaj rrethit të ngushtë shoqëror, i cili është në të vërtetë nxitësi kryesor, me normat e sjelljeve të veta, që të zbatohet hakmarrja. Mund të themi me plot bindje se shumë nga këta ekzekutues të hakmarrjes do të hiqnin dorë nga një vepër e këtillë sikur të mos i shtrëngonte opinionin publik, shoqëria në të cilën jetojnë, që të ndërmarrin një aksion

të këtillë të përgjakshëm dhe tepër të dëmshëm nga çdo pikëpamje. Edhe Hasimja vuan nga kjo atmosferë shoqërore dhe vendos të bëjë atë që as normat e vrazhda të një shoqërie të tillë nuk e obligojnë.

Kush ishte Hasimja trime

Këngën e Hasimes për herë të parë e kam pasë dëgjuar aty nga viti 1927 në fshatin Janosh, afër Gjakovës, nga daja im Sadri Mehmeti. Më vonë këtë këngë e pata shënuar në fshatin tim Gllavicë afër Pejës nga Prend Delia e Ndue Sadiku në vitin 1939. Pas lufte, më 1954 këtë këngë e pata botuar në revistën letrare „Jeta e re” në Prishtinë. Mirëpo, kureshtja që të mësoj diçka më shumë për protagonisten më përcillte vazhdimisht dhe kështu më shpuri në qershor të vitit 1974 në fshatin e Hasimes, në Mirash.




Fig. 1. Pamje nga fshati Mirash

Fshati Mirash, ku është zhvilluar ngjarja, ndodhet nja 25 km në lindje të Prishtinës. Sipas statistikës zyrtare të vitit 1971, Mirashi ka pasur në atë vit 182 shtëpi me 1231 banorë. Të gjithë banorët e këtij fshati janë shqiptarë. Katundi ndahet në tri mëhallë: mëhalla e Rraçit, ajo e Hashanëve dhe mëhalla e Xhamisë. Këto mëhallë gjenden në disa kodrina të vogëla, kështu që formojnë tërësi të vogëla në vete, dhe, megjithëse, që të gjitha përbëjnë një fshat, ato janë pakës të veçuara njëra prej tjetrës nga një terren kodrinor ku rrjedh një përrua i vogël. Fshati përbëhet nga disa fise dhe barqe, siç janë: Hashanët (me fis Krasniqe), pastaj, Thaç, Bytyq, Sop etj.

Kuptohet sot fshati ka ndryshuar dukshëm në krahasim me atë që ishte (aty kah vitet 1920) dhe më parë. Shumë shtëpi janë të asaj kohe, por edhe më shumë ka ndërtesa të reja, mes të cilave dallohet shkolla tetëvjeçare me më se 400 nxënës. Fshati ka rrymë elektrike, disa traktorë dhe maqina të tjera bujqësore, ndërsa më se 30 fshatarë janë në punë të përkohshme në Gjermani dhe në shtete të tjera. Pra, në kushte të reja, këtu lulëzon një jetë e re. Nuk ka mes fshatarëve as grindje as hakmarrje. Çdokush punon tokën e vet dhe kalon një jetë të qetë, në mirëkuptim dhe në dashuri me fqinj-të, ndërsa brezi i ri shkollohet dhe hap rrugë të reja e perspektivë edhe më të mirë për Mirashin, vend i një ndodhje të dikurshme tragjike.

Bisedën mbi Hasimen, mbi Mirashin e dikurshëm, e kam zhvilluar me Rifat Bytyqin, plak 74 vjeç, në shtëpinë e tij, mu në qendër të Mirashit, në afërsinë e një kopshti, ku shiheshin konturat e themeleve të shtëpisë së Hasimes dhe me disa fshatarë të tjerë. Kopshti kishte mbetur djerr ndërsa shtëpia ka kohë ishte rrënuar. Rifat Bytyqi, kishte qenë njëri nga fqinj-të e parë të Hasimes, madje, gati moshtar i saj — vetëm dy vjet më i ri se ajo dhe ishte në kontakt të përditshëm me Hasimen dhe me vëllazërit e saj. Pra, plaku Rifat mund të flasë me kompetencë mbi jetën e Hasimes dhe mbi ngjarjet tragjike që ajo përjetoi. Shënime mbi këtë dhanë edhe disa fshatarë.

Hasimja duhet të jetë e lindur aty kah viti 1898 në fshatin Slivovë, në rrethinat e Lipjanit, ku edhe tani i ka axhallarët. Babai i kishte vdekur kur Hasimja ishte ende fëmijë. Kjo familje, në Slivovë, mbante gallapin Tyfek, gjë që jep të kuptojmë se edhe në gjeneratat e mëparme mund të ketë pasur njerëz të pushkës. Kjo familje është Sop, ndërsa dajët e Hasimes janë Elshan. E ëma e Hasimes ka qenë nga fshati Mirash, prej kah është martuar në Slivovë. Ndërsa ishte Hasimja fëmijë, kësaj i vdes i jati. Familja e të jait kishte prejardhjen nga fshati Sojevë afër Ferizajt. Nëna e Hasimes quhej Arife. Pas vdekjes së burrit të saj ajo kthehet në Mirash tek vëllazërit e vet me dy djem — Aliun e Shabanin dhe me Hasimen Mbetet i pashpjegueshëm kthimi në gjini i Arifes me të gjithë fëmijët mbas vdekjes të burrit të saj Ibrahimit. Si duket, edhe më vonë, axhallarët e Hasimes nuk janë interesuar shumë për fatin e këtyre fëmijëve, të cilët kanë kaluar në Mirash një jetë të mjerë dhe më në fund shumë tragjike.

Dajët e Hasimës ishin pesë vëllazër: Meha, Isufi, Hajdini, Rama e Sejdiu. Zot shtëpie ishte Sejda (Sejdiu). Këta ia falën motrës së vet pak tokë, dhe aty në skaj të kopshtit të tyre ia ndërtuan një kasollë. Kur u rritën vëllazërit e Hasimes, Aliu dhe Shabani, ata blenë edhe pak tokë në fshatin e tyre. Vëllau i Hasimes, Shabani, më vonë martohet me një vajzë nga fshati Okllap afër Janjevës. Hasimja gjithashtu ishte bërë për martesë dhe këtë e japin mu në atë shtëpi prej së cilës kishte marrë gruan Shabani. Duket se ky ndërrim femrash duhet të jetë bërë nga varfëria e të dy palëve, sepse

martesa atëherë kushtonte shumë sipas zakonit patriarkal të vendit, dhe në këtë mënyrë janë evituar shpenzimet e mëdha. Hasimja pat një djalë. Burri i vdiq shpejt e kjo u detyrua të kthehet në Mirash të vëllezërit e saj, ndërsa djali mbetet në Okllap në familjen e babait të vet. Bashkëbiseduesi Rifat Bytyqi thotë se djali i Hasimes është gjallë, por nuk dinte të tregojë asgjë përveç kaq. Ndërkohë Hasimes i vdes edhe nëna. Familja e Hasimes jetonte në varfëri.

Sipas kallximit të plakut tetëdhjetëvjeçar Hasan Thaçi nga Mirashi, djali i Hasimes quhet Qerim. Ai është ende gjallë dhe mund t'i ket nja 50 vjet. Sipas këtij plaku Hasimja u gjykua dhe u dënua në Prishtinë e jo në Ferizaj si thuhet në këngën popullore, gjë që është afër mendësh, sepse atëherë Ferizaj ka qenë një lokalitet i vogël ku ndoshta nuk ka pasur fare gjykatore. Ky gjithashtu thotë se Hasimja mbajti burgun në Pozharevac ku vdiq, gjë që gjithashtu nuk përkon me të dhënat e parashtruara në këngën që e kemi në shqyrtim. Por të shohim tani si janë zhvilluar ngjarjet në Mirash.

Aliu, vëllau i Hasimës, shkon ushtar si „bedel” në vend të Hamdi Matoshit nga Nikodimja afër Ferizajt. Atëherë afati ushtarak ishte shumë i gjatë. Në kohën e sundimit osman ata që ishin të pasur paguanin ndonjë njeri të varfër për të shkuar ushtar në vend të tyre. Kështu, Aliu shkon gjashtë vjet ushtar. Në atë kohë behej luftë (duket se kjo ishte koha e luftërave ballkanike). Aliu plagoset dhe zehet rob nga francezët, nga robëria kthehet kur „këtu ishte bullgari” (dukët gjatë Luftës së Parë Botërore). Kështu ai kishte kaluar si ushtar ndonjë vjet më shumë se sa ishte afati i paraparë. Me të kthyer, Aliu kërkon nga Hamdi Matoshi që ky ta paguajë edhe për ata vjet që kishte kaluar si rob lufte. Mirëpo Hamdiu refuzon kërkesën e tij, duke i thënë se këtë e kishte dërguar ushtar për gjashtë vjet e jo më tepër. Kështu fillon ngatërresa që vjen duke u ndërlikuar gjithnjë e më shumë gjer në gjakderdhjet tragjike të mëvonshme.

Aliu kishte kaluar një jetë plot vuajtje, sepse ishte shumë i varfër dhe për këtë arsye ai kishte vajtur gjashtë vjet ushtar për tjetërkend që, me të hollat e marra nga Hamdi Matoshi, të ndihmonte familjen e vet. Kështu, pra, vuajtjet e tij, përveç varfërisë së madhe në familje, kishin qenë shumë të rënda. Për këtë shkak ai ishte i bindur se kishte të drejtë të kërkojë nga Hamdiu shpërbli-min përkatës për gjithë kohën që kishte qenë ushtar, kuptohet, edhe për kohën që kishte kaluar si rob lufte. Refuzimi i Hamdisë Aliut i dukej si shkelje e të drejtave të tij dhe shfrytëzim i vrazhdë. Prandaj, kishte vendosur që të drejtat e veta t'i realizojë me çdo kusht. Dhe ja si u zhvilluan ngjarjet më vonë.

Në fshatin Mirash Hamdi Matoshi kishte dajën e vet. Ai vjen njëherë te daja për t'i ndihmuar që të kryente punët, në arë dhe, meqenëse ishte koha e lavres Hamdiu merr dhe qetë me vete. Ishte „koha e bullgarit” (1917), Hamdiu shkon të lëvrojë me qe në arë të dajës, Xhumë Rashitit. Aliu mendon se tani ishte një rast i përshtatshëm që të realizojë të drejtën e vet, të cilën ia mohonte Hamdi Matoshi. Merr pushkën dhe shkon në arë të Xhumës për t'ia marrë

qetë Hamdiut. Për këtë gjë ai i tregon edhe Hasimes. Mirëpo, para se të arrinte në arë Aliu, filloi të bjerë shi dhe Hamdiu lë punën dhe kthehet në shtëpi të dajës. Kështu nuk takohet fare me Hamdinë. Ndërkohë vjen në shtëpi vëllai i Aliut, Shabani, i cili nuk kishte ndodhur aty kur Aliu kishte marrë një vendim të tillë dhe nuk dinte asgjë për këtë. Hasimja i tregon se Aliu kishte shkuar në arën e Xhumës që t'ia rrëmbejë qetë Hamdiut. Shabani shpejt rrok pushkën e niset duke vrapuar për në arë. Rrugës takon Xhumë Rashitin. Shabani mendon se edhe Xhuma kishte qenë në arë bashkë me Hamdiun dhe dyshon se të dy ata do ta kenë vranë vëllain e tij, Aliun. Ishte i bindur madje se duhet të ketë ngjarë kështu, sepse Xhuma ishte i njohur si komit. Prandaj, pa u marrë vesh fare me të, dredh pushkën dhe shtie kundër tij. Mirëpo plumbi shkon huq. Xhuma, i shkathët dhe i stërvitur me armë, shtie dhe e plagos Shabanin. Duke menduar se Shabani kishte mbetur i vdekur, Xhuma ik në mal. Më vonë Shabani shërohet nga plaga që kishte marrë në këmbë dhe me ndërmjetësinë e njerëzve të fshatit, bëhet pajtimi mes tij e Xhumës. Xhuma i paguan Shabanit 25 lira për „gjysëm gjaku” (për plagë).

Mirëpo, pas një kohe Shabani e Aliu përsëri bien në konflikt me Xhumën. Xhuma si duket ishte njeri i ngatërresave dhe guximtar. Atij i pëlqente jeta në mal si komit dhe kishte vranë shumë vetë nga këto vise. Xhuma fshehej nëpër miq e kushërinj dhe shpesh vinte fshehtas edhe në Mirash.

Një ditë pranvere, në kohën e mbjelljeve, (siç tregon bashkëbiseduesi Rifat Bytyqi), Aliu e Hasimja ishin duke punuar në arë. Në atë kohë edhe Rifati ishte duke mbjellur në arën e tij që nuk ishte larg arës tyre. Gjatë një pushimi ai shkon dhe rri pak me Aliun e Hasimen si fqinj i mirë që ishte me ta. Vëlla e motër mbarojnë punë pak para mbrëmjes dhe nisen për në shtëpi. Ndërkohë Xhuma kishte ardhur tinës dhe kishte zënë pusinë bashkë me ca shokë të vet në një pyll, nga kalonte rruga për në fshat. Hasimja e Aliu, të lodhur nga puna e rëndë ecnin me hapa të ngadalshëm rrëzë pyllit. Hasimja mblidhte rrugës krande, dhe e kishte mbushur plot krahun. Aliu shkonte pak përpara me dy shetër në krah. Papritmas nga pylli dëgjohen disa të shtëna dhe Aliu bie vdekur nga plumbat e Xhumës me shokë. Hasimja shpejt lëshon krandet dhe i bie vëllait përsipër, sepse ndërkohë gjaksorët kishin dalë nga pylli e vraponin në drejtim të viktimës. Aliu nuk kishte pushkë me vete, prandaj edhe Hasimja ishte duarthatë. Ajo në këtë moment i bie sipër Aliut që ta mbrojë nga gjaksorët. Mirëpo, këta edhe për së rëni e gjuajnë disa herë Aliun, derisa binden se është i vdekur dhe ikin shpejt në mal.

Rifat Bytyqi thotë se i ka dëgjuar të gjitha të shtënat, mirëpo, meqenëse në mes tij dhe vendit të ngjarjes ndodhej një kodër, ai nuk shihte asgjë, dhe mendonte se këto janë të shtëna të zakonshme të padëm, sepse atëherë çdokush mbante armë. Por, duke u kthyer mbas pak kohe edhe ai në shtëpi po asaj rrugë, sheh aty rrë-

zë malit, një krah krande dhe një përrockë gjaku. Në fshat mëson ngjarjen tragjike dhe shkon në shtëpinë e Hasimes ku e gjen duke vajtuar kufomën e të vëllait.

Xhuma, sipas thënieve, ishte bërë tmerr për këto vise, sepse vriste njerëz edhe nëse nuk i njifte, vetëm në qoftë se dikush e paguante për t'iu hakmarrë ndonjë armikut të vet. Ai vinte natën ndonjëherë edhe në Mirash, sidomos te njëfarë Musë Arifi, i cili e kishte shtëpinë në skaj të fshatit, afër pyllit. Hasimja dhe Shabani nuk kishin preokupim më të madh se hakmarrjen ndaj Xhumës. Kjo ishte bërë opsion i vërtetë. Madje, edhe disa fshatarë me sjelljet e tyre e nxitnin këtë hakmarrje, sepse mbanin lidhje të fshehta me Xhumën, ndërsa Shabanin e nënçmonin si njëri të vetmuar, të pakrah dhe të varfër, i cili „nuk kish kaçik” të bëjë diçka kundër Xhumës, që ishte komit i njohur. Mirëpo, Shabani ishte trim. Ai një ditë i thotë Musa Arifit se bën gabim nëse e mban në shtëpi Xhumën. Musa i përgjigjet me arogancë, duke i thenë se ai nuk ka të drejtë të përzihet në shtëpinë e tij, e cila është e hapur për Xhumën dhe mund të jetë e hapur edhe për ndonjë tjetër, sipas qejfit të tij. Madje, Musa i thotë se edhe atë natë do ta kishte Xhumën në konak. Kjo e fyen së tepërmi Shabanin. Një ditë tjetër ai merr pushkën dhe shkon në pyll për dru. Atje e gjen Musën dhe e vret. Shabani del pastaj në mal.

Xhuma mori vesh se Musa u vra për shkak të tij. Shabani kërkonte Xhumën që ta vrasë e Xhuma kërkonte Shabanin. Xhuma kishte shokë me vete dhe shumë jatakë. Shabani nuk gjeti shokë në mal dhe nuk kishte as jatakë. Mund të shkonte ndonjëherë fshehtës në fshatin Papaz afër Ferizajt, në shtëpinë e Brahim Papazit. Duket se as axhallarët në Sllovinjë, as dajët në Mirash nuk interesoheshin për fatin e tij e të Hasimes. Kështu pra, Shabani ishte i vetmuar në mal e Hasimja e vetmuar me nënën në Mirash. Në fshatin Prelez (afër Ferizajt) Shabani kishte një teze, ku gjithashtu shkonte ndonjëherë rrallë.

Një natë rastësisht ndodhin njëkohësisht në Papaz, Xhuma me shokët e vet në konak të Xhelil Papazi e Shabani të Brahim Papazi, duke mos ditur asgjë për njëri tjetrin. Mirëpo, një fshatar që simpatizonte Xhumën merr vesh dhe e lajmëron se Shabani gjendet në Papaz. Pas darke Shabani nis të zotin e shtëpisë, Brahimin, dhe me dy vëllazërit e tij për në Prelez, ku e kishte tezen. Kur dalin prej Prelezit, bien në pusi të Xhumës. Me këtë rast vritet Shabani dhe dy vëllazërit e Brahimin, ndërsa Brahimin plagoset. Kjo mund të ketë ngjarë aty kah viti 1919 ose 1920. Kështu tragjedia e Hasimes u dyfishua. Motra mbeti pa asnjë vëlla.

Mbas pak kohe gruaja e Shabanit kthehet në gjini. Një vajzë që kishte lënë pas vetes Shabani, ishte rritur dhe shpejt u martua në Gumnosellë afër Lipjanit. Hasimes ndërkohë i vdiq e ëma, kështu mbeti fare vetëm, me zemër të plasur për Aliun të cilin ia mbyti Xhuma para syve dhe për Shabanin që kishte humbur kokën e vet duke u përpyetur të marrë hakun e të vëllait. Gjendja e Hasi-

mes ishte tepër e vështirë. Mirëpo, ajo nuk shqetësohej për veten e saj. Brenga dhe qëllimi i vetëm i jetës për të ishte hakmarrja. Por ajo ishte një grua e vejë dhe shumë e varfër për të marrë gjakun e vëllezërve duke paguar dorasin. Mashkull nuk i kishte mbetur në familje që do të digjte fyshekun për këtë qëllim. Rrethi i saj, fsha-




Fig. 2. Prapa gardhit ndodhet kopshti ku ka qenë shtëpia e Hasimes

tarët e Mirashit e shikonin me sy të ndryshëm. Shumëkush nuk i afrohej fare derës së saj, e cila për ta dukej e njollosur dhe e tillë do të mbetej gjithmonë, sepse s'kishte kush të luftonte për të marrë hakun, për t'ua zbardhur fytyrën në varr Shabanit e Aliut. Për të tjerët Hasimja ishte një grua e mjerë, e pakrah, e pafat, grua e shtëpisë së turpëruar.

Hasimja ishte shumë koshiente për pozitën e saj në një shoqëri të këthillë. Ajo kërkonte rrugëdalje, kërkonte mënyrën si të marrë gjakun e vëllezërve të saj. Ishte grua e një natyre të gjallë, ishte e shkathët. Kishte një shtat të gjatë e të hollë. Flokë ngjyrë të çelur dhe sy të kaltër. Nuk kishte ndonjë bukuri të dalluar, por ishte tërheqëse, kishte një qëndrim serioz dhe impononte me personali-

tetin e saj, kështu që njerëzit kishin ndaj saj respekt. Ishte jo vetëm shtëpiake e mirë dhe e pastër, por edhe punëtore e zellshme në fushë. Ishte „grua gjallnike“, e zonja për çdo punë.

Duke mos pasur rrugëdalje tjetër, Hasimja vendos të martohet, jo nga qejfi ose për të siguruar jetën e vet, por vetëm e vetëm që në këtë mënyrë t'ua marrë gjakun vëllezërve të vet. Prandaj burri i saj eventual duhej të ishte ai që do ta merrte këtë detyrë të rëndë mbi vete. Ai duhej të ishte „burrë i çarkut“, që s'i trembet syri as nga Xhuma i tmershem.

Kjo, pra, ishte Hasimja e pafat. Themi e pafat, sepse për këtë dëshmon jo vetëm tragjedia e vëllezërve të saj, por edhe jeta e saj bashkëshortore. Ajo si grua e re mbetet e vejë, dhe i duhet të ndahet nga i vetmi djalë që kishte e të shkojë te nëna dhe vëllezërit që jetonin të varfër në fshatin Mirash. Mirëpo, kjo nuk e rëndon shumë. Ajo që ishte për të një barrë tepër e rëndë ishte vdekja tragjike e vëllezërve, siç shihet edhe nga vargjet e poetit, i cili me gojën e Hasimes thotë:

*„... vra m'i kanë vllaznit e mij,
fikë ma kanë të zezën shpi,
kanë lanë nanën me duer n'gji,
motër zezën pa vllazni.“*

Derisa kishte nënën gjallë, Hasimja e ndante këtë tragjedi familjare me të, mirëpo pas vdekjes së saj e gjithë kjo barrë kalon mbi supet e saj, duke iu shtuar, kuptohet, edhe dhimbja për prindin e humbur. Tani ajo mendonte se vetëm me një martesë të re mund të përmirësohej kjo situatë. Prandaj, ajo qet fjalën dhe fjala merr botën.

Martesa e dytë e Hasimes

Për fshatarin kosovar martesa gjithmonë ka qenë një problem i madh, sepse ajo ishte e lidhur me zakone prapanike që e rëndojnë shtëpinë e dhëndrrit me shpenzime të mëdha. Prandaj, fjala e Hasimes për martesën e saj të dytë u përhap shpejt. Madje, gruaja e vejë ishte gjithmonë e çmuar dhe e preferuar për martesë, sidomos nga njerëzit në moshë ose vejanët. Kjo përparësi u jipet për arsye se gruaja e vejë është e zonja e punës, e mësuar të kryejë të gjitha detyrat e shtëpisë, e pjekur nga çdo pikëpamje dhe e sigurtë që do të ketë fëmijë (nëse ka pasur dhe me burrin e parë). Mirëpo, nga ana tjetër, rasti i martesës së Hasimes ishte shumë specifik dhe i vështirë. Ajo nuk martohej vetëm që të kishte burrë, por, para së gjithash

kërkonte një hakmarrës. Prandaj, ofertat për martesë nga ana e meshkujve nuk ishin të shumta, megjithëse Hasimja kishte të gjitha kushtet e tjera për ta lakmuar shumëkush. Madje, sipas këngës popullore, Hasimja i premtonte burrit të saj shumë gjëra të tjera materiale, gjë që ndodh shumë rrallë në fshatrat tona.

*„A ka kund ndoj burrë dai
qi lufton për vllazën t'mij?
Po jap tokën me tapi
jap dugajën me mulli,
vetë po bâhna grueja e tij!”*

Kuptohet se këto premtime ishin shumë të mëdha. Mirëpo, edhe kushti ishte shumë i vështirë. Çdokush e dinte se, nëse pranon të bëhet burrë i Hasimes, duhej të kishte punë me Xhumën, i cili gjithashtu ishte i njohur si njeri që kishte bërë shumë krime.

Këto vargje të këngës popullore në të vërtetë vetëm pjesërisht përputhen me realitetin. Premtimet e Hasimes janë vetëm hipërbolizim i poetit popullor, sepse Hasimja ishte e varfër dhe nuk kishte as duqan as mulli, por vetëm një copë tokë të vogël dhe një kasolle në kopshtin që ua kishte dhënë daja, kur erdhën në Mirash si jetima me nënën e tyre.

Për t'u martuar me Hasimen ishte interesuar shumë Lilë Begraca nga fshati Begracë, afër Kaçanikut. Lila ishte edhe vetë koçak, sa rrinte në shtëpi sa dilte në mal. Pra, ishte person i përshtatshëm që mund të pranonte kushtet e Hasimes, sepse Lila, si koçak, mund ta vriste më lehtë një koçak tjetër, konkretisht Xhumën. Lilë Begraca duket se për këtë punë bisedon me dajën e Hasimes — me Sejdën. Në traditën popullore, në zakonet e lashta, në një ambient patriarkal, daja luan një rol të posaçëm në çdo punë që ka të bëjë me nipërit ose mbesat e tij e sidomos kur është rasti i fejeses ose i hakmarrjes për nipërinjtë e vvarë. Sejda konkretisht kishte aq më tepër të drejtë të merrte rolin e ndërmjetësuesit për martesën e Hasimes, sepse kjo kishte mbetur fare e vetmuar, meqenëse axhët e saj nuk tregonin interesim për të.

Sejda i thotë Hasimes se këtë e kërkonte për grua Lilë Begraca, i cili ishte i gatshëm t'ua marrë hakun vëllezërve të saj.

*„N'koftë se m' merr Hasimja mue,
kam për vllazën me i luftue”...*

Lila nuk përmend as duqan as mulli, të premtuar nga Hasimja atij që do ta merrte për grua. Lila do vetëm të martohet me Hasimen, duke marrë mbi vete obligimin e rëndë të hakmarrjes. Prandaj edhe ndërmjetsimi i Sejdës është i shprehur në këtë frymë:

*„— Oj Hasime, mori bijë,
Lilë Begraca po t'lypë ty.
Ti për Lilën n'daç me shkue
ka për vllazën me t'luftue”.*

Kuptohet se Hasimja ishte e gatshme të marrë qoftë Lilën, qoftë dhe ndonjë tjetër që do të luftonte për vëllezërit e saj. Mirëpo, ajo ishte një femër e pakrah, prandaj donte një garancion, te daja i saj Sejda. Këtë e shpreh bukur poeti popullor kur thotë:

*„Si n'm'u bafsh ti, dajë, dorzan,
une Lilën kam m'e marrë,
kam m'e marrë, për tâ me shkue,
veç për vllazën me m'lufue”.*

Sejda nuk kishte arsye të mos i besonte Lilës, që njihej si trim i mirë, siç kanë qenë zakonisht komitët. Prandaj, sipas këngës popullore, ai merr përsipër dorëzaninë. Por është e logjikshme që ngjarja të jetë zhvilluar mu ashtu siç e thotë kënga, sepse Hasimja nuk kishte njeri më të afërm se dajën. Kështu Hasimja bëhet gati dhe shkon nuse për herën e dytë.

Kjo martesë qe modeste, për arsye se ajo marrohej nga halli e jo për qejf, ishte e pikëllueme nga tragjedia familjare, e vejë dhe e varfër. Të gjitha këto ia impononin Hasimes që nusëria e saj e dytë të kalojë fare në heshtje:

*„Shpejt Hasimja asht shtërngue
n'Begracë nuse për me shkue.
Ni palë kundra i shtjen n'kambë,
po shkon nuse pa bojë, pa kanë...”*

Boja për ngjyrosjen e flokëve dhe këna janë elemente të domosdoshme për zbukurimin e nuses, por Hasimja nuk dëshiron të bëjë as më të vogëlin gjest për të hieshuar veten. Ajo shkon nuse „pa kanë”, pa darsmorë dhe pa këngë të rastit. Porsa arrin në shtëpinë e Lilës, e pyet përsëri (sipas këngës popullore)

*„Ore Lilë, ore dai,
a lufton për vllazën t'mij?”*

Premtimi nga ana e Lilës është kategorik dhe i bindshëm:

*„Hajt Hasime, mos kij dert,
ta faroj Mirashin krejt!”*

Hasimja duhet të ketë qenë e kënaqur me burrin e saj në ditët e para. Lila jo vetëm që do të hakmerrej për vëllezërit e Hasimes „kokë për kokë” sipas Kanunit të Lekës, por siç thuhet në këngë ishte në gjendje të shkatërrojë edhe fshatin e Xhumës për hir të Hasimes, do të thotë se, nëse nuk do të mund të vriste Xhumën, i cili mshifej në mal, do ta mërrte hakun në farefisën e tij në Mirash.

Mirëpo, edhe gjaksi, Xhumë Rashiti, ishte informuar mirë për kushtet e martesës së Hasimes. Ai gjithashtu ia kishte frikën Lilës, sepse edhe ky kishte disa njerëz të vet që mund ta ndihmonin për t'i rënë në gjurmë. Prandaj, Xhuma bënte çmos që të mos bjerë në grackë të Lilës. Ai kishte edhe shumë gjaqe të tjera mbi kokë, por për ato nuk brengosej shumë. Derisa Hasimja ishte e pamartuar, Xhuma s'kishte kurrfarë frike nga hakmarrja për gjaqet e vëllezërve të saj, sepse nuk kishte mbetur mashkull pas tyre që do të luftonte për ta. Mirëpo, martesë e saj ndryshoi situatën, dhe tani Xhuma kishte frikën kryesore mu nga hakmarrja e Hasimes.

Mashtrimi i Lilës dhe hakmarrja e Hasimes

Lilë Begraca jetonte në qetësi me Hasimen, pa ndonjë trazim, sepse kjo ishte grua dhe shtëpiake e mirë. Nga ana tjetër, Hasimja përpiqej që ndaj burrit të jetë edhe më e kujdesshme, meqenëse nga ky priste të kryejë hakmarrjen. Gati nuk kishte ditë që nuk bisedonin mbi planet e Lilës që të kryejë sa më parë obligimin e vet. Mirëpo, këto plane zgjatën tepër.

*„Shkuen dy muej e shkuen dy vjet —
pushka e Lilës s'po kërcet!”*

Këto dy vargje kanë depërtuar në gjuhën e popullit anë e mb'anë Kosovës, si frazeologjizmë për të qortuar atë që premtën e nuk kryen punë.

Hasimes i kishte hyrë në zëmër fitili i dyshimit ndaj Lilës. Gjithnjë e më tepër po bindej se Lila nuk ishte njeri i fjalës. Nga ana e tij, Lila ia kishte arrijtur qëllimti të vet, duke u martuar me një grua të mirë dhe kalonte një jetë të qetë. Tani vendos të mos hyjë në telashe me Xhumën, sepse sikur ta vriste, ai do të binte në gjak. Prandaj kërkonte rrugëdalje tjetër.

Xhuma gjithashtu përpiqej me anë të njerëzve të vet që të merrej vesh disi me Lilën për pajtimin e gjaqeve. Këta të dy ishin komitë dhe si të tillë ishin të rrezikshëm për shoqishojnë. Të dyve u le vërdiste një marrëveshje, e cila do të evitonte hakmarrjen. Nga ana tjetër, Lilës nuk i ishte vrarë ndokush nga farefisi i tij, kështu që, sipas zakonit të vendit e të Kanunit, ai nuk kishte as të drejtë, as obligim të drejtpërdrejtë që të hakmerrej. Obligimi që kishte marrë ndaj Hasimes ishte një lloj pazarllëku që do ta shpiente në ngatërresa të reja të përgjakshme. Kështu Lila vendos të pajtojë gjaqet e Ha-

simes me Xhumën. Pra një ditë e fton Xhumën në shtëpi me disa njerëz të tij për të pajtuar gjaqet. Për këtë gjest poeti popullor e dënon Lilën me fjalë të rënda:

*„Lilë Begraca qën ish kânë,
s'mbajti fjalën qi e kish dhanë.
Kqyr ky Lila çka ka marue —
hasmit fjalë i paska çue
me ardhë gjaqet me i pajtue”.*

Kuptohet që pabesia, çfarëdo qoftë, e ul njeriun shumë poshtë në sytë e popullit shqiptar, tek i cili besa është një ndër virtytet më të çmuara etnike. Ai që nuk e mban fjalën, nuk ka më vend ndër burra as ndër njerëz të ndershëm. Një nga proverbat e shumtë popullorë mbi besën thotë „Kau për brinash lidhet e burri për fjalë”. Prandaj, duhet të kuptohet edhe poeti popullor kur Lilës ia jep atributin „qen”, që do të thotë — njeri shumë i poshtër. Në realitet, shikuar nga aspekti etik, Lila bën një punë me vend, sepse ai kështu mundëson të ndërpritet gjakderdhja dhe të pajtohen dy palët e ngatërruara. Ky gjest i Lilës pra, nga ana morale është pozitiv dhe i dobishëm. Mirëpo, morali nuk ka norma absolute. Nuk ekziston në botë një kantar i përbashkët, që do të tregonte peshën dhe vlerën absolute të moralit. Normat morale ndryshojnë sipas kohës, sipas mesit gjeografik, sipas kategorive shoqërore etj. Për ambientin ku jetonte Hasimja, për një shoqëri të një shkalle shumë të ultë zhvillimi të përgjithshëm, të ngarkuara me zakone prapanike dhe me paragjykime të ndryshme, Lila, që nuk e mban fjalën e dhënë për të kryer një krim (për të marrë gjakun), është njeri që i thyen keq normat morale të shoqërisë, në të cilën bënte edhe ai pjesë. Prandaj edhe poeti popullor e krahason me një kafshë.

Edhe në momentin e fundit Hasimja prapëseprapë shpresonte se Lila do ta mbante fjalën. Prandaj, kur i thotë Lila se i kanë ardhur njerëzit e tij besnikë, të cilët do të luftonin për vëllezërit e saj, dhe e porositi të bëjë gati një drekë të mirë për këta miq të rrallë, atëherë:

*„Fort Hasimja kanka gzue ...
Ni sillë t'mirë e ka gatue —
kish mytë pulë, petë kish t'hollue”.*

Sipas zakoneve prapanike të vendit, gruaja nuk hyn në dhomën e miqve as në shtëpinë e vet kur ka ndonjë të huaj mysafir. Ajo merr urdhëra nga burri çka duhet të përgatisë dhe këto i sjell gjer te dera, ku me një trokitje të vogël, ose me ndonjë shenjë tjetër, bën me dije burrin, që është me miqtë, të dalë përjashtë. Kështu ka ngjarë atë ditë edhe me Hasimen. Mirëpo, nga se ishte tepër e interesuar çka po bisedohej në dhomën e miqve, ku nuk guxonte të hyjë, ajo

afrohet te dera dhe vëzhgon bisedën e burrave. Hasimja mbetet e habitur së tepërmi kur dëgjon se Lila dhe Xhuma bisedojnë për pajtimin e gjaqeve. Ndërkohë Lila del për t'ua sjellë drekën miqve.

Hasimja e mahnitur dhe tepër e zëmëruar i thotë se ka dëgjuar ç'ka biseduar ai me „probatimat”, madje kishte njohur edhe zërin e Xhumës së urrejtur, dhe shton se tani do të hynte në dhomë për ta vrrarë vetë gjaksorin. Lila e njifte mirë Hasimen — ajo ishte e fjalës dhe, atë që thonte, e realizonte. Prandaj, kthehet në dhomë dhe u thotë komitëve se Hasimja i ka marrë vesh të gjitha dhe tani do të vijë për të vrrarë Xhumën. Koçakët shpejt dalin nga dhoma dhe ikin në mal.

Në këngën popullore nuk përmendet ky moment. Sipas këngës, Hasimja, me të dëgjuar bisedën e burrave, shkon në dhomën e vet, vishet si mashkull, armatoset dhe shkon në Mirash për t'u hak marrë. Kjo ndodh pak më vonë, ndoshta të nesërmën, ndërsa atë natë ajo bën që cubat e malit t'ua mbathin këmbëve e Lila të turpërohet para saj dhe para burrave që i kishte ftuar në shtëpi.

Prej këtij momenti Hasimja nuk humb më kohë. Ajo sheh se Lila e ka mashtruar në mënyrë dinake. Nuk i mbetet asgjë tjetër përveç të marrë rolin e burrit të marrë hakun e vëllazërve me dorën e vet. Janë të bukura vargjet që përshkruajnë detajet e përgatitjes së Hasimes për këtë aksion të rëndë:

*„ . . . po vesh tirq, po vesh xhurdi,
e kish vnue ni plis të ri,
pshtjellka kryet me ni shami,
n'xhep po e shtijka ni kuti,
n'shokë e mshef t'shkretën allti,
drejtë Mirashit paska msy”.*

Kënga popullore tregon ngjarjen e mëtejshme pak ndryshe e jo siç ka ndodhur në të vërtetë. Sipas pohimeve të bashkëbiseduesit Rifat Bytyqit, Hasimja vjen në Mirash e veshur në rroba të burrave dhe shkon më parë në shtëpi të Xhumës me shpresë se do ta gjejë aty. Mirëpo, duke mos e njohur fare se kush është „ky djalë i ri”, i thonë se Xhuma nuk ndodhet në shtëpi. Hasimja kishte vendosur të mos kthehet e gjallë atë ditë pa e marrë gjakun e vëllazërve. Ajo sheh se me këtë rast nuk do të mund të takohej me gjaksin, prandaj vendos të vrasë ndokend nga familja e Xhumës, sepse edhe në këtë mënyrë merrej gjaku dhe „zbarrdhej fytyra”. Prandaj shkon në oborr të axhës së Xhumës, Islam Rashitit. Po t'i jepej rasti, Xhumën do ta likuidonte një herë tjetër. Në këto momente dramatike ajo ishte në gjendje të derdhë shumë gjak. Tani, kur ishte prishur edhe me Lilën, ajo nuk kishte as plang as shtëpi, as mik as farefis. Hasimja nuk ishte më Hasime, por trim që kishte vendosur të luftojë deri në vdekje.

Ndonëse e tronditur për shumë arsye, Hasimja në këtë moment tragjik permban vetën. Me asnjë gjest, me asnjë fjalë nuk duhet të ngjallë as më të vogëlin dyshim. Qellimit duhet t'ia arrijë me çdo kusht.

Ishte vjeshtë. Në këtë kohë fshatarët xhveshin misrin, vëndojnë tallën dhe ushqimin tjetër për bagëti. Të gjithë në këtë kohë punojnë diçka në oborr, në shtëpi, në lëmin e sanëve, sepse puna në fushë ka marrë fund. Kështu edhe Islami, që e kishte shtëpinë pranë asaj të Xhumës, ishte duke xhveshur misër në një skaj të oborrit bashkë me gratë dhe vajzat e shtëpisë. Sipas këngës, Hasimja me të hyrë në oborr, thërret për emër të zotin e shtëpisë. Del një grua dhe zhvillohet ky dialog:

- *Ku i ki burrat, mori hallë?*
- *Qatje n'lamë tuj vnue ni tallë.*

Hasimja drejtohet kah talla në lëmë, ku takohet me Islamin. Këto janë momentet e fundit para kulminacionit të dramës. Poeti popullor edhe në këto momente Hasimen e paraqet shumë të qetë dhe të matur. Ajo, me një gjakftohtësi të zakonshme, i uron Islamit punë të mbarë dhe dëgjon, gjithashtu e qetë, përgjegjen e tij:

- *„Puna e mbarë more dai!*
- *Të mbar paç, or djalë i ri!*

Islami nuk di se me kë ka të bëjë. Për atë Hasimja ishte vetëm një „djalë i ri”. Sipas këngës popullore, dhe sipas zakonit të mikpritjes, Islami nxierr kutinë e duhanit dhe ia shtrin Hasimes. Në atë moment Hasimja *me dorë t'shmajtë e merr kutinë, me dorë t'djathtë e nxjerr alltinë*. Kënga pastaj vazhdon — *fort u ndez alltija flakë, vrau Islamin me gjithë t'vllanë*.

Kështu, momenti për të cilin Hasimja jetonte dhe endërronte vite me rradhë vjen në rrethana të paplanifikuara, vritet njeriu që s'kishte lidhje me krimin e Xhumës. Hasimja ishte e bindur se kreu një detyrë të shenjtë, por në të vërtetë ajo vetëm bën një krim, sepse vritet njeriu i pafajshëm.

Sipas fjalëve të fshatarëve të Mirashit, Hasimja ka vrarë Islamin ndërsa ky ishte duke xhveshur misër („qironte kollomboq”), e jo pasi zhdryp nga talla. Ajo pra vret vetëm Islamin, e jo edhe „të vllanë”, si thuhet në këngë, sepse ky nuk ka pasur fare vëlla. Në një variantë tjetër thuhet se Hasimja *Xhem Mirashin e ka vra*. Në të vërtetë, ajo ka vrarë xhaxhain e Xhemës Islamin e askend tjetër. Rapsodi popullor ka dëgjuar emrin e gjaksit gabimisht. Ai quhej Xhumë, mirëpo nga se ky emër është shumë i rrallë, në këngë përmendet si Xhemë. Por si thamë, Hasimja nuk e gjeti hasmin e vërtetë (Xhumën), dhe kështu ajo vrau axhën e Xhumës.

Në momentin e vrasjes së Islamit aty ngat ndodhin disa gra e vajza të shtëpisë. Një vajzë hudhet dhe përleshet me Hasimen. Kjo

gjuan dhe kundër kësaj vajze, por plumbi i kalon vetëm nëpër rroba. Hasimja ishte armatosur me një revole të madhe „të karadakut” me mulli. Ajo duke u përleshur me vajzën dhe me njerëzit e tjerë të shtëpisë, shkëputet nga këta dhe merr ikjen. Mirëpo, aty afër një fqi i quajtur Ahmet Salihi ndërtonte shtëpinë me mjeshtër. Këta i vihen prapa Hasimes dhe e zënë. Fshatarët mbeten pa mend kur shohin se ky „djalë i ri” paska qenë vetë Hasimja. E marrin dhe e dorëzojnë në komunë që atëherë ishte në Babush të Shkive. Prej këtej policët e komunës e çojnë në Ferizaj në prefekturë, ku ishte „naçallnik” (prefekt) Mita Bogdanoviçi.

Hasimja në burgun e Nishit

Hasimen e nxjerrin para gjyqit në Ferizaj dhe dënohet me 12 vjet burg. Në një variante të këngës popullore thuhet se ajo u dënua me 17 vjet burg. Sidoqoftë, duket se Hasimja ka pasur në gjyq qëndrim burrëror, sepse, si thotë kënga:

*„Hiç Hasimja s'po ka dert,
ka luftue për vllazën t'vet.
Shkon n'hapsane tuj fol, tuj keshë”.*

Ajo nuk çan kokën për dënimin e rëndë që ia shqipton gjyqi. Përkundrazi, Hasimja krenohet për veprën që ka kryer. Madje ajo kërkon nga prefekti që ta lirojë vetëm një ditë, të shkojë deri në Begracë për ta vrarë edhe Lilën që e kishte mashtruar:

*„Naçallnik, more zotni,
a m'ep izë me shkue në shpi,
ta shoh Lilën, at faqezi?
Ta shoh Lilën me kët allti;
t'koftë dhanë besa, prap po vij!”*

Kuptohet se kjo dëshirë nuk iu plotësua. Mirëpo, emri i Lilë Begracës mbeti në këngë popullore si sinonim i njeriut të pabesë.

Nga Ferizaji Hasimen e çojnë në burg të Nishit. Atje për dymbëdhjetë vjet duhet të qëndrojë e mbyllur brenda mureve të ftohta, ku ndonjë rreze e vogël drite mund të depërtojë vetëm nëpër rrjetën e hekurave të trashë të dritareve të ngushta. Mirëpo kjo Hasimes nuk i bën përshtypje. Ajo është shumë e kënaqur për aktin e kryer. I mbetet në zemër vetëm edhe një dëshirë e ndrydhur ajo që ta takojë „Lilën me këtë allti”.

Hasimja mbetet trime edhe brenda mureve të larta të burgut të Nishit. Këtë e dëshmon shumë më bindshëm se sa herën e parë, kur vrau axhën e pafajshëm të gjaksit të vëllezërve të vet, në Mirash. Këtu Hasimja, në çelizën e errët të burgut bën një trimëri të pashoqe duke ia zbardhur vetës fytyrën, të cilën tentoi t'ia njollosë një kapter, rojtar i burgut. Ja si ndodhi kjo ngjarje.

Hasimja ishte ende grua e re dhe kishte një qëndrim krenar që e bënte edhe më tërheqëse. Pushka e shprazur në Mirash ia kishte ngritur famën shumë larg. Prandaj Hasimja ishte grua në zë. Kjo gjë shkonte në favor të kualiteteve të saj që mund të tërheqin dhe më shumë vëmendjen e meshkujve. Në burg ishte roje një kapter, i cili ishte mësuar keq me gratë e tjera që ndodheshin aty. Ai mendonte se edhe Hasimja mund të binte në duar të tij të ndyta dhe kështu një natë i afrohet të shtrati, duke i bërë lajka të pavend. Në këngën popullore kapteri i thotë:

*„— Igballmirë paskam qillue,
igball t'mirë paskam sivjet
bashkë me i çue dymëdhetë vjet”.*

Mirëpo, Hasimja nuk ishte grua e luhatshme siç mendonte ai. Ajo vinte nga viset ku nderi çmohej mbi çdo gjë. Për nder e për fytyrë ajo kishte qitur pushkë duke vënë jetën e vet në rrezik, megjithëse një gjest i tillë nuk i takonte një gruaje, sepse me „punë” të tilla merreshin vetëm burrat. Ajo as që mendonte se gjendët në burg dhe në duar të huaja. Për mbrojtjen e nderit edhe burgu mund të shndërrohej në fushë beteje. Kapteri, për të kënaqur epshin e tij shtazarak e sulmon Hasimen. Mirëpo, ai harron se kishte të bëjë me një grua të qëndrueshme dhe, këtë „harresë” e paguan shtrenjtë. Hasimja, në vetëmbrojtje rrok një shtambë plot ujë që kishte pranë dhe me tërë fuqinë e qëllon kapterin në kokë dhe e lë të vdekur në vend. Këtë moment tragjik poeti popullor e përshkruan kështu:

*„Fort Hasimja kanka ngushtue,
'i gërçak ngat i ka qillue,
me tâ ballit ia ka mshue,
pa pikë shpirti e ka lshue.”*

Në të vërtetë, nëse duhet të përmendet trimëria e Hasimes, atëherë trimërinë më të madhe e ka bërë mu me këtë rast, kur në vetëmbrojtje e mbyt me një kënatë uji sulmuesin e armatosur. Në qoftë se poeti popullor ishte dashur t'i thonte Hasimes „t'u thaftë dora” për vrasjen e Islamit të pafajshëm, atëherë për vrasjen e kapterit mund ta uronte me gjithë zemër „të lumtë dora e djathtë!”

Edhe për këtë vrasje Hasimja nxirret përsëri para gjyqit. Fshatarët e Mirashit thonë se kjo ngjau një muaj para se të lirohej nga burgu, ndërsa kënga popullore këtë ngjarje e vë në ditët e para, në fillim të mbajtjes së dënimit. Një variantë tjetër e këngës popullore thotë se në gjyq Hasimen nuk e dënojnë fare për vrasjen e kapterit, sepse ka luftuar për mbrojtjen e nderit të vet:

*N'istintak gjyqi po e qet —
ja falë gjyqi katër vjet”.*

Pra, sipas poetit popullor, gjyqi tregohet shumë i arsyeshëm, dhe jo vetëm që nuk e dënon fare, por ia zbret edhe katër vjet nga dënimi i mëparshëm. Fshatarët e Mirashit thonë të kundërtën. Hasimja dënohet edhe për këtë vrasje, por si dhe sa nuk dijnë të tregojnë. Sido që të ketë qenë, nga kënga popullore shohim se disa vjet më shumë ose më pak, për atë nuk kishin rëndësi. Ajo ishte e kënaqur dhe krenare, sepse kishte mbrojtur nderin e vet:

*„Hiç Hasimja s'po ka dert,
ka luftue për ftyrë të vet,
shkon n'hapsane tuj folë, tuj keshë”.*

Me kaq mbaron kënga e Hasimes. Rapsodi popullor nuk di asgjë më tepër për fatin e saj. Madje, si u pa më lart, ai edhe disa fakte nuk i paraqet si duhet, prandaj diçka shton, diçka lën mëngju, por në përgjithësi ngjarjet kryesore janë interpretuar me mjaft besnikëri.

Disa ngjarje që kanë ndodhur në lidhje me Hasimen e me ca personazhe të tjera që u përmendën më lart janë shumë interesante. Po i përmendim këtu vetëm shkurtimisht, që mos të largohemi shumë nga subjekti ynë kryesor..

Sipas tregimit të bashkëfshatarëve të Hasimes, Xhuma ishte bërë problem për një rreth më të gjerë në këto vise. Ai ishte njeri i malit, dhe duket se jeta e njeriut nuk peshonte shumë në peshojën e tij. Thuhet se kishte vrarë nja njëzetë vetë. Ndër të tjerat vepra të këqia Xhuma kishte marrë me përdhunë një vajzë për grua nga fshati Sllakovc (afër Gilanit). Atë e mbante me vete në mal, ose nganjëherë e lente fshehtas te ndonjë mik i tij. Kështu, për një kohë e le atë në Mirash, te Xhemë Mustafa, që kishte shtëpinë afër pyllit në një skaj të fshatit. Familja e saj nuk ka ditur fare për nja 5-6 muaj se ku gjendej ajo. Me ndihmën e Xhemës dhe të Sejdës (të dajës së Hasimes), vajza ik e kthehet në shtëpinë e vet. Për këtë punë Xhuma ngatërrohet keq me Xhemën e me Sejdën. Mirëpo këta, duke pasur frikë nga hakmarrja e Xhumës, nxitojnë që t'ia hanë kokën atij më parë. Kështu, sipas pohimeve të fshatarëve, me anë të një kaçaku që quhej Govor, Xhuma bie në pusinë e gjindarmëve diku afër Preshvës me ç'rast vritet Xhuma dhe një nga shokët e tij. Ky ishte për Hasimen një sihariq, sepse u zhduk ai që ia kishte vrarë vëllezërit. Nga ana tjetër, edhe daja i saj në këtë mënyrë tregon një interesim për nipat e vrarë, për çka kishte qenë qysh më parë i obliguar sipas zakonisht të vendit.

Për fatin e Lilë Begracës me këtë rast nuk dëgjuam asgjë. Duket se pas vrasjes që bëri Hasimja, ai u tërhoq dhe u fsheh, sepse, nga një anë, nuk kishte fytyrë të dalë para botës, ngase e kishte mashtruar Hasimen dhe, nga ana tjetër, për shkak se vrasja që bëri Hasimja e ngarkonte edhe Lilën, sepse në atë moment ai ishte burri i saj legjitim, megjithëse për këtë barrën kryesore, sipas Kanunit, duhet ta mbanin babai dhe vëllezërit e saj. Por ata nuk ishin gjallë.

Më i rëndësishëm dhe më interesant është padyshim fati i mëtejshëm i vetë Hasimes. Për ta njohur më mirë Hasimen, jetën e saj tragjike, do të nevojiteshin hulumtime të posaçme arkivore, nëse janë ruajtur dokumentat e periudhës 1924-1925 në gjyqet e në burgun që përmendën në këngë. Mirëpo me këtë rast po përmendim fare shkurt vetëm ca momente interesante që tregohen sot në Mirash për Hasimen.

Në atë kohë, kishin vajtur t'i vizitojnë të burgosurit, për të parë kushtet në të cilat jetonin shqiptarët në burgun e Nishit, dy deputet të atëhershëm të parlamentit jugosllav, Sherif Voca e Ferat Draga. Atje ishte edhe Hasimja. Ajo me këtë rast ankohet se ia kishin shtuar dënimin, megjithëse kapterin e kishte vrarë duke mbrojtur veten nga sulmi i tij brutal. Posa u kthye në Beograd Sherif Voca, që atëherë ishte mik i oborrit mbretëror të Karagjorgjeviqëve, shkon te mbreti Aleksandër dhe kërkon që ta lirojë Hasimen nga burgu. Kuptohet se për mbretin kjo ishte një punë e vogël në krahasim me „miqësinë” që kishte me Sherif Vocën, i cili si deputet mund të ishte i dobishëm për politikën e Karagjorgjeviqëve në Kosovë. Prandaj ai pranon kërkesën e Sherifit. Shpejt shkon lajmi në Sllovinjë, te nipat e Hasimes që të shkojnë e ta marrin Hasimen nga burgu i Nishit. Mirëpo, kur këta arrijnë, drejtori i burgut u thotë se Hasimja ndërkohë kishte vdekur. Ai ua tregon një arkivol të llamarinës, të mbyllur hermetikisht, duke u thënë se nuk duhej ta hapnin kurrëse sepse e ndjera kishte vdekur nga një sëmundje e rëndë ngjitëse. Nga ana tjetër, ai i bind se hoxha ia kishte bërë të gjitha zakonet fetare të rastit.

Aty ndodh një shqiptar i burgosur dhe u thotë tinës kushërinjve të Hasimes të mos e merrnin kurrëse arkivolin, sepse Hasimja ishte e gjallë e në arkivol kishin futur një copë lis, aq sa peshon një grua e vdekur. Kushërinjtë refuzuan ta marrin arkivolin, duke thënë se nuk kishin të holla për transportimin e tij dhe dhanë përlqimin që ta varroste drejtorja e burgut ku të donte.

Ku qëndron e vërteta në lidhje me këtë ngjarje, është vështirë të përgjigjemi me saktësi. Para se gjithash, është e vërtetë se „vde kja” e Hasimes ishte një trillim, një gënjeshtër dinake dhe antihumane. Hasimja ishte shëndosh e „mirë” në burgun e Nishit në momentin kur drejtorja e nxori arkivolin me „kufomën e saj”. Mund të bëhet që këtë makinacion ta këtë bërë vetë oborri mbretëror, duke urdhëruar drejtorinë e burgut në Nish që të veprojnë në këtë mënyrë. Kështu, deputeti do të mbetej i kënaqur për suksesin që pat fjala e tij te mbreti, ndërsa, nga ana tjetër, Hasimja do të mbetej edhe më tutje në burg. Mirëpo, kjo ka më pak mundësi që të ketë ngjarë mu kështu, sepse herdo kurdo Hasimja do të dilte nga burgu dhe gënjeshtera do të dilte në shesh. Sikur të ishte ky makinacion pjellë e politikës dhe praktikës satrape të oborrit mbretëror, atëherë sigurisht Hasimen do ta likuidonin në burg, sepse ajo edhe ashtu „kishte vdekur”.

Në lidhje me këtë na duket më real një supozim tjetër. Në Hasimen dashurohet më vonë një major. Nuk dihet a ishte edhe ky nga roja e burgut, apo ndonjë person tjetër. Hasimja vendos më në fund të martohet me majorin. A ka ngjarë kjo pa plotësuar Hasimja të gjitha ditët e burgut, apo pasi ka dalë nga burgu, kjo nuk mund të përcaktohet. Ndoshta nga burgu i rëndë, në kushte shumë të vështira, në të cilat ka kaluar shumë vjet, Hasimja mund të jetë mërzitur e thyer psiqikisht dhe ka pranuar të martohet me një oficer, i cili duhet t'i ketë premtuar lirin nga burgu. Kjo mund të ketë ngjarë ndoshta mu në ditet kur lirohet Hasimja, megjithëse supozimi i parë na duket më i bindshëm. Tek e fundit Hasimja mund të ketë dëshiruar ndoshta vetë që të humbasë përgjithmonë gjurmat e saj, duke e shpallë vetën „të vdekur”. Kjo mënyrë veprimi evitonte njëkohësisht mundësinë e hakmarrjes nga ferefisi i Hasimes. Sidoqoftë, Hasimja nuk do ta shohë kurrë më Mirashin e saj, as tokën e Kosovës, sepse fati i saj u lidh me Nishin, pa marrë para sysh se a ishte kjo me dëshirën e saj apo jo.

Një episod tjetër, në lidhje me fatin e Hasimes, është më i freskët dhe i përngjet ndonjë pamjeje nga filmat që paraqesin situata të papritura. Aty kah viti 1962 (mund të jetë pak më parë ose pak më vonë) një fshatar nga Slivova shkon në Nish me tren për të shitur ve në tregun e atjeshem. Dikur, aty në piacë, i afrohet një grua dhe hyn në pazar me këtë. Merren vesh për çmim, por me kusht që ky t'ia sjellë vezët në shtëpi. Kur vinë në shtëpi të saj, gruaja fillon ta pyesë nga është. Fshatari i tregon se është nga Kosova. Gruaja i thotë se këtë e kishte kuptuar porsa e kishte parë në piacë me plis të bardhë në kokë, por dëshironte të dijë nga cila krahinë e Kosovës dhe nga cili fshat ishte. Ky i thotë se ishte nga Slivova afër Ferizajit. Gruaja e pyet a mos njeh ndokend nga fshati Sllovinjë, nga fshati Mirash. Fshatari i përmend shumë emra nga fshati Sllovinjë. Në bisedë e sipër fshatari i tregon zonjës së shtëpisë edhe ngjarjen e Hasimes, e cila i ka nipat e vet në Sllovinjë. Atëherë kjo i thotë: „Une jam Hasimja prej Sllovinje”. Kjo e befason tepër fshatarin. Mirëpo, më në fund ai bindet se gruaja nuk gënjente, sepse filloi të flasë me të shqip dhe e pyeste për shumë fshatarë të asaj ane. Ndërkohë, vjen burri i Hasimes me dy djemtë e tyre. Hasimja shfaq dëshirën që të takohet me nipat e saj, mirëpo ata nuk dëshironin që të ngjallehin „plagët e vjetra” dhe kështu dëshira e saj nuk realizohet.

Thuhet se kah viti 1969 paska vdekur Hasimja në Nish. Kështu mbyllen faqet e historisë së një gruaje trime, por shumë të pafat dhe shumë tragjike. Asaj nga farefisi nuk ia din askush as ditën e saktë të vdekjes, as varrin. Për botëkuptimet e një ambienti patriarkal, fama që gëzonte Hasimja në këto vise bie në hije të dendur të ngjarjeve që pasuan — të martesës së saj të fundit. Njerëzit e saj, dhe ata që e kanë njohur, dëshirojnë që Hasimja t'u mbetet në kujtim, ashtu siç është rrënjësuar në kujtesën e tyre. Dëshirojnë që Hasimja të jetë gjithmonë ajo që ka qenë në Begracë, në Mirash dhe në burgun e Nishit. Por, ashtu sikurse janë të pavend, të paarsyeshme

nga aspekti moral, lavdatat që i bëhen për disa „trimëri” (vrasja e axhës së dorasit), aq është i pavend dhe i paarsyeshëm dënimi dhe faji që mund t’i ngarkohet për martesën e saj të mëvonshme. Kjo aq më tepër kur nuk dihet se në ç’kushte ka pranuar Hasimja një martesë të tillë.

Sidoqoftë Hasimja mbetet e pavdekshme në këngën popullore, e paharrueshme dhe e admiruar te ata që dëgjojnë këngën e saj. Ata gjithmonë do ta përfytyrojnë Hasimen si një protagoniste kre-shnike, të cilës nuk iu tremb syri para komitëve që vajtën në shtëpinë e saj për të pajtuar tinës gjaqet e vëllzërve të saj me Lilë Begracën. Komitetët ua mbathën dikur këmbëve e nuk pritën që Hasimja e tërbuar nga tradhëtia e Lilës të hynte me revole në dorë në dhomën e miqve. Hasimes nuk i qe trembur syri që duke luajtur rolin e mashkullit, ditën për diell të kërkonte, me revole të fshehur në shokë, gjaksin e vëllzërve, Xhumë Rashitin, i cili kishte qenë komit i njohur. Në vend të tij vret axhën e tij ndër sy të gjithë fshatit. Aq më pak i trembet syri nga gjindarmët dhe organet gjyqësore.

Edhe në burg, ajo është e njëjtë si në Begracë, si në Mirash, si te „naçallniku” në Ferizaj. Në kushte të një të burgosuri Hasimja mbron nderin e vet nga një sulmues i paturpshëm. Për të gjitha këto Hasimja është krenare, sepse ajo është e bindur se të gjitha këto vepra të saj janë shumë të drejta, janë në përputhje të plotë me moralin specifik të një ambienti, të një rrethi, të një shoqërie patriarkale, të një kohe dhe të kushteve të saj. Ajo është e bindur se vepron mu ashtu siç do të vepronte çdo burrë, me plot kuptimin e kësaj fjale, i këtij ambienti të caktuar gjeografik dhe shoqëror. Për më tepër, mu ky rreth, ky ambient dhe kjo kohë e shoqëri, nga e cila kishte dalë edhe vetë Hasimja, ishte nxitja kryesore, me normat e moralit të vet, që Hasimja të bëjë atë që bëri.

Kështu, pra, për një ambient dhe për një shoqëri të këtillë, Hasimja është dhe do të mbetet vetëm një grua trimëreshë, një grua fisnike me të gjitha atributet e tjera që mund t’i ketë një protagoniste zemërçeliku në poezinë tonë popullore.

Dy fjalë mbi origjinën e këngës së Hasimes

Të flasësh për origjinën e një kënge të vjetër popullore, të kërkosh autorin e saj, është gati njësoj sikur të kërkosh gjilpërën në det. Kënga popullore e vjetër nuk ka autor të caktuar, ajo është e popullit, i cili pasi ta këtë dëgjuar njëherë nga ndonjë rapsod popullor, shton, heq dhe përgjithësisht ndryshon diçka në këtë këngë dhe kështu dalngadalë populli vetë bëhet autori i saj. Kjo vlen para së gjithash për këngët e vjetra, të cilave nuk u dihet autori. Kështu mund të themi edhe për këngën e Hasimes. Nuk dihet asgjë se kush e kur e thuri në vargje ngjarjen tragjike dhe protagonisten Hasimen.

Mirëpo, nëse për autorin e saj themi se është — vetë populli, mund të shtojmë diçka mbi përhapjen e kësaj kënge ndër ne. Kënga e Hasimes nuk ka lindur në truallin e ngjarjes, por shumë më larg. Kjo mund të konstatohet nga toponimet dhe antroponimet që përdoren në këtë këngë, dhe, nga ana tjetër, kjo mund të shihet edhe nga variantet e ndryshme (motërzimet), që nuk e paraqesin të gjithë ngjarjen, madje ndonjëra nga këto vetëm disa vargje.

Për herën e parë, për sa dimë, kjo këngë u botua ndër ne në Prishtinë më 1953, në blenin e II të *Këngëve popullore shqiptare të Kosovës-Metohisë* (faqe 199-201). Kënga e Hasimes këtu është e gjymtuar, e përgjysmuar, është më e dobët se ajo që kisha dëgjuar qysh si fëmijë, aty nga viti 1930 dhe të cilën e kisha shënuar në tërësi në fshatin tim Gllaviçicë (afër Pejës) qysh më 1939, botuar në revistën letrare *Jeta e re*, nr. 4, viti V, 1954, f. 381-386, të shoqëruar me një koment të rastit. Varianta e parë tregon ngjarjen vetëm deri kur Hasimja vret axhën e gjaksit, dhe ka gjithsejt 93 vargje, ndërsa varianta që kam shënuar unë tregon ngjarjen në tërësi, si u paraqit më lart, dhe ka gjithsejt 148 vargje. Një variantë tjetër e kësaj këngë është botuar në librin e Lorenc Antonit *Folklor muzikor shqiptar*, bleni i parë, Prishtinë, 1956, f. 60 më gjithsejt vetëm 9 vargje. Autori ka bërë një punë të mirë që me këtë rast ka botuar notat e melodisë së kësaj kënge, gjë që ka qenë madje qellim kryesor i tij. Nga revista, *Jeta e re* këtë këngë e ka ribotuar Demush Shala në librin e tij *Këngë popullore historike*, Prishtinë, 1973, f. 381-383, jo me titull që e ka në *Jetën e re* (Kanga e Hasimes), por me titull: „Unë po kaj për dy vllazni”. Nuk më ka rënë rasti të shoh edhe ndonjë botim tjetër të kësaj kënge.

Nga këto tri motërzime që janë botuar, si edhe nga disa këngëtarë që kam pasur rastin t'i dëgjoj, dhe nga disa variante që i ka Instituti Albanologjik, shihet se toponimet e vendeve ku është zhvilluar ngjarja, nuk janë ato që duhet të jenë. Kështu, përshembull në varianten e botuar në *Jetën e re* fshati Begracë, që është afër Kaçanikut, ka ndryshuar dhe emërtohet me trajta të ndryshme — Grocë (Lila i Grocës paska ndi) dhe me Graboc (Lilë Graboci po të lypë ty). Groca, për sa dimë, nuk ekziston, mirëpo ekziston fshati Graboc afër Pejës. Kjo na bën të kujtojmë se kënga e Hasimes mund të ketë lindur mu në këto vise në rrethinat e Pejës e të Gjakovës. Kuptohet se ky është vetëm një supozim, por nuk është dhe larg mendësh. Ja se pse. Edhe fshati i Hasimes, Mirashi, në këtë variantë, për të cilën po flasim, ndryshon dhe quhet Mirosh (Ta faroj Miroshin krejt). Nga këta dy shembuj mund të konstatojmë se kjo këngë nuk ka lindur në pllajën e Kosovës, në atë trevë që në pikëpamje gjeografike quhet Kosovë e që shtrihet prej Kaçanikut e gjer në Mitrovicë (rreth 80 km gjatësi, me një gjerësi më të madhe rreth 10 km). Sikurse kënga të kishte lindur në këtë trevë, patjetër do të ishin në vargjet e saj edhe emrat e këtyre dy fshatrave ashtu si quhen, sepse këto në këtë anë, njihen fare mirë, nga se largësia mes fshatrave të Kosovës nuk është e madhe.

Antroponimet mund të kenë më pak rëndësi në përcaktimin e origjinës së këngës, sepse emrat e njerëzve mund të mos njihen fare edhe brenda një rretli më të ngushtë. Megjithatë, sikur të kishte lindur kënga e Hasimes në afërsinë e fshatit të saj, edhe antroponimet do të shenoheshin ashtu si duhet, do të diheshin emrat e vërtetë të personazheve që përmenden në këtë këngë.

Nga variantet e pabotuara të kësaj kënge që gjenden në Institutin Albanologjik të Prishtinës, më interesante është ajo që është më e gjatë (139 vargje), shënuar në fshatin Sylevicë. Në këtë motërzim bie në sy përshkrimi më i hollësishëm i martesës së Hasimes me Lilë Begracën. Me këtë rast Hasimja këtu paraqitet grua shumë e emancipuar për kushtet dhe gjendjen e atëhershme të gruas në vitet tona:

*„— Nuk muj, dajë, me t'ngue ty
pa e pa Lilën me kta sy..”*

*„... Hasja Lil'n e ka shikue,
dajës vet kshtu i ka kallxue,
Hasja dajës kshtu po i flet:
— S'muj m'e marrë Lilën sivjet;
s'paska sy gjinen qi e vret.”*

*„... — Mirë po e dij, për grosh po m'shet.
Opet t'mbramen e bāj vetë”*

Hasimja don ta shohë vetë burrin e ardhshëm, gjë që ndër ne, në të kaluarën, gruaja nuk e bënte në asnjë rast. Nga ana tjetër, ajo thotë haptas se Lila nuk ia mbushte syrin si burrë që mund të luftojë. Më në fund, kur daja hyn dorëzan, Hasimja pranon këtë martesë, por i thotë edhe dajës se ai këtë „me grosh po e shet”. Megjithatë Hasimja qysh tani ishte e vendosur se „të mbramen” duhet ta bëjë ajo vetë, mun ashtu si qe e detyruar ta bëjë.

Përsa i përket origjinës së këngës, edhe ky motërzim tregon se rapsodi popullor, autori i kësaj kënge, duhet të ketë qenë nga një regjion më larg vendit të ngjarjes. Kjo për arsye se fshati Begracë këtu quhet Begrovci dhe nga ana tjetër këtu nuk përmendet fare burgu i Nishit, ku e kanë shpënë Hasimen mbas gjykimit në Ferizaj, po thuhet vetëm se „N'hyqymet Hasën e kanë çue.../Ni xhandar Hasës përmbas iu ka vndue” etj. Një personazh i ri që nuk përmendet në motërzimet e tjera, figuron në këtë variantë të fundit. Është fjala për njëfarë Hoxhë Visokën që paska qenë atëherë në burg, të cilin Hasimja e lut t'ia shkruajë një letër:

*„Hoxhë Visoka aty ish qillue.
— Fol, bre motër, çka po thue?
— Ti ni letër me ma shkruue,
Lilë Begracës me ja çue —
s'ish kanë burrë, as s'ish kanë grue!”*

Në rreshtat që pasojnë Hasimja thotë: „*N'paça ymër prej burgu me dalë, / Bell Mavriqin s'e la pa e marrë!*” Edhe ky emër i ri (Bell Mavriqi) është një moment që mund të tregojë se rapsodi popullor ka futur vetë në këngën e tij një burrë të përmendur në rrethin më të ngushtë të autorit të kësaj variante.

Sidoqoftë, duket se variantja më e plotë është ajo e botuar në *Jetën e re*, e cila mund të ketë shërbyer si pasqyrë për thurjen e motërzimeve të tjera të shumta. Këtë mendim e shfaqën edhe disa banorë të fshatit Mirash, kur zhvilluam bisedën me ta mbi historikun e Hasimes. Ata thonin se ndër këto vise nuk ka njerëz që „qesin kangë të mira. Kangëtarë të mirë ka nahija e Pejës dhe e Gjakovës”. Kuptohet se ata nuk e dinin se edhe në vise të tjera kemi „njerëz që qesin kangë” madje shumë të mira, mirëpo është e vërtetë se thesari i poezisë popullore në këto vise, në Rrafshin e Dukagjinit, është më i pasur se në regjionet e tjera të Kosovës.

Varianta e këngës së Hasimes që e shënova në vitin 1939 paraqet me mjaft besnikëri ngjarjen tragjike në fshatin Mirash dhe qëndrimin burrëror të Hasimes në burg të Nishit. Mirëpo, as kjo variante nuk është e plotë. Më vonë, më 1959, pata rastin ta dëgjoja përsëri këngën e Hasimes mu nga Sadri Mehmeti nga fshati Janosh, prej të cilit e kam pasë dëgjuar qysh në fëmijëni. Mirëpo, tani këtë këngë e dëgjoja me një interesim më të madh dhe me një kuptim tjetër, kështu që u përpoqa ta shënoj varianten më të plotë të saj. Këngëtari Sadri Mehmeti edhe vetë ishte njeri i pasionuar për këngët popullore. Këto i këndonte shumë shpesh, qoftë në shtëpinë e vet, qoftë në vendet publike në raste të përshtatshme. Nga goja e tij mbeti si trashëgim varianta më e plotë dhe më e bukur e këngës së Hasimes, të cilën po e botojmë me këtë rast në tërësi.

KANGA E HASIMES

- Moj Hasime, mori bi,
ç' ki Hasime qi kán ti
— Unë po kaj për dy vllazni,
vra m'i kanë vllaznit e mij,
5 fikë ma kanë të zezën shpi,
kanë lanë nanën me duer n'gji,
motër zezën pa vllazni.
M'i ka vra i pari kojshi,
m'i çorroi kta dy sy.
10 A ka kund ndoj burrë dai
qi lufton për vllazën t'mij?
Po jap tokën me tapi,
jap dugajën me mulli,
vetë po bâhna grueja e tij!

- 15 Lilë Begraca paska ndi.
Mejherë Lila âsht shtërgue,
te daja i Hasës paska shkue,
dajës 'Hasës i ka kallxue:
— N'koftë se m'merr Hasimja mue
- 20 kam për vllazën me i luftue,
krejt Mirashin m'e farue;
ni motmot s'ka me kalue.
Daja i Hases kanka çue,
te Hasimja paska shkue,
- 25 qato fjalë ia ka kallxue:
— Oj Hasime, mori bi,
Lilë Begraca po t'lyp ty.
Ti për Lilën n'daç me shkue
ka për vllazën me t'luftue.
- 30 Nuk muj, dajë, me t'ngue ty
pa e pá Lilën me kta sy.
Daja i Hasës kanka çue,
drejt te Lila paska shkue.
Te Hasimja bashkë kanë shkue.
- 35 Hasja Lil'n e ka shikue,
dajës vet kshtu i ka kallxue,
Hasja dajës kshtu po i flet:
— S'muj m'e marrë Lilën sivjet;
s'paska sy gjinen qi e vret.
- 40 Daja Hasës i paska thanë:
— Unë po t'hi, Hase, dorzan;
mos qitë Lila, i vras vetë!
Prap Hasimja dajës po i flet:
— Mirë po e dij, për grosh po m'shet.
- 45 Opet t'mramen e bâj vetë.
Si n'm'u bâfsh ti, dajë, dorzan,
une Lilën kam m'e marrë,
kam m'e marrë, për tâ me shkue,
veç për vllazën me m'luftue.
- 50 Iu ka bâ daja dorzan.
Shpejt Hasimja âsht shtërngue
n'Begracë nuse për me shkue.
Po shkon nuse, pa bojë, pa kânë,
ni palë kundra i shtjen n'kâmbë;
- 55 ni palë kundra n'kambë i shtini,
kështu te Lila nuse mrrini.
— Ore Lilë, ore dai,
a lufton për vllazën t'mij?
— Hajt, Hasime, mos kij dert,

- 60 ta faroj Mirashin krejt!
Shkuen dy muej e shkuen dy vjet,
pushka e Lilës s'po kërset!
Lilë Begraca qën ish kânë,
s'mbajti fjalën qi e kish dhanë.
- 65 Kqyr ky Lila çka ka marue —
hasmit fjalë i paska çue
me ardhë, gjaqet me i pajtue.
Shpejt te Lila janë bashkue.
— Oj Hasime, mori grue,
- 70 ni sillë t'mirë me na e marue,
probatimat po m'vinë mue,
donë për vllazën me luftue!
Fort Hasimja kanka gzue,
ka hi n'magje me gatue;
- 75 ni cillë t'mirë e ka gatue —
kish mbytë pulë, petë kish t'hollue.
Bukën n'odë kur jau ka çue,
(â) ndalë mbas dere tuj vezhgue
me i ngue burrat tuj dertue
- 80 hasmin plumb qysh duhet m'e gjue.
Po e ndien hasmin tu' u levdue:
— T'bana me shpi, Lilë, t'bana me grue.
Po i ndien gjaqe tuj pajtue.
Fort Hasimja âsht idhnue,
- 85 opet bukën n'shpi e ka çue.
Kopil Lila, e kish hetue,
mbas Hasimës n'shpi â shkue.
— Ç'ki Hasime, a je tranue?
— Mos t'lashtë zoti, Lilë, pa t'marrue!
- 90 Ke thirrë hasmin me u pajtue;
m'ke shti për hasëm me gatue.
— S'e kam thirrë unë me u pajtue,
e kam mendën m'e trathtue.
Lila n'odë shpejt kanka shkue.
- 95 — Çonu, shokë, ju për me shkue,
se Hasimja ju ka hetue,
po don krejt me u tranue!
Mejherë hasmi kanka çue,
në shpi t'vet ai paska shkue.
- 100 Shih Hasimja çka ka mbarue —
n'qiler t'vet Hasja ka shkue.
Kjo Hasimja ish kânë ni bi,
hjek kushak e hjek dimi,
po vesh tirq, po vesh xhurdi,

- 105 e kish vnue ni plis të ri,
pshtjellka kryet me ni shami,
n'xhep po e shtijka ni kuti,
n'shokë e mshef t'shkretën allti,
drejt Mirashit paska msy.
- 110 Fill n'derë t'Xhemës paska shkue,
thrret ni herë. Po del ni grue.
— Ku i ki burrat, mori hallë?
— Qatje n'lamë tuj vnue ni tallë.
Hip n'shkallë t'gardhit me ra n'lamë.
- 115 Kur n'shkallë t'gardhit shkel me kambë,
Xhema tall'n e kish mbarue;
(e) kish mbarue, po don me zhdrypë,
po don Hasën m'e marrë ngrykë.
— Puna e mbarë! — Hasja i ka thanë. —
- 120 Puna e mbarë, more dai!
— Të mbarë paç, or djalë i ri!
Ia qet Xhema qat kuti.
Kqyr Hasimja çka kish bâ —
me dorë t'shmajtë po e merr kutinë,
- 125 me dorë t'djathtë e nxjerr alltinë.
Fort u ndez alltija flakë —
e vrau Xhemën me gjith t'vllanë.
Xhem Mirashi paska britë:
— Largou, kush mos iu avit!
- 130 S'kanka djalë, po kanka çikë,
e paska çue zoti me m'fikë!
E muer ikën Hasja me pshtue.
Çika e hasmit mbas ju vndue:
— Prit, Hasime, ku don me shkue!
- 135 Qysh ma vrave babën mue?
Me 'i t'furk Hasës i ka mshue.
Por Hasimja ish kânë bi,
shpejt po i shkon dora n'allti.
Kjo patrrolla kanka çue,
- 140 mbas Hasimës ju ka vnue.
N'kollomoq Hasja â palue.
— More vend, ti kofsh mallkue,
ni trohë mal qysh s't'ka qillue!
S'pata shpirtin ku m'e pshtue;
- 145 xhandarria m'kanë rrethue.
Ni xhandar shiptar â qillue
edhe Hasës shqip po i flet:
— Hajde, motër, ti me besë,
kush me dorë s'guxon me t'prekë

- 150 për pa t'çue n'hyqymet!
Paska msy Hasja me ikë.
Fort po ik Hasja livadhit,
pa vonue vjen n'buz t'tasjanit,
n'buzë t'tasjanit në Prishtinë.
- 155 Po hipë Hasja n'ni maqinë;
n'maqinë Hasja s'vonon hiç
paska zhripë në Ferzoviq.
Mbas haberi i ka shkue:
„Ketë farë njeri mos m'e lshue!”
- 160 Shum xhandarë e kanë rrethue,
por s'guxojnë me ju afrue.
Kur i terron Hasja sytë,
tanë xhandart ikin çarshisë.
N'hyqymet vetë kanka shkue,
- 165 naçallnikut iu ka dorzue.
— Naçallnik, more zotni,
a m'ep izë me shkue në shpi
ta shoh Lilën, at faqezi,
ta shoh Lilën me kët allti?
- 170 T'koftë dhanë besa, prap po vij!
— S'muj Hasime, për me t'lshue,
se zakoni po m'rrxon mue.
Fill në gjyq Hasja â shkue.
N'istintak gjyqi po e qet —
- 175 ja preu gjyqi dymdhetë vjet.
Hiç Hasimja s'po ka dert,
ka luftue për vllazën t'vet.
Shkon n'hapsane tuj folë, tuj keshë.
Disa gra aty i ka gjetë.
- 180 Ni „narednik” ish kânë msue keq —
naredniku kish pasë zanat
me u shkue grave natë për natë.
Kqyr akshami kur âsht ba,
naredniku aty âsht ardhë.
- 185 Naredniku kur ka hi,
po e sheh Hasën si zotni.
Kish nisë llafin me llafue,
nisë Hasimen m'e qortue:
— Igballmirë paskam qillue,
- 190 igball t'mirë paskam sivjet
bashkë me i çue dymdhetë vjet.
Fort Hasimja kanka ngushtue,
i gërçak ngat i ka qillue,
me tâ ballit ia ka mshue,

- 195 pa pikë shpirti e ka lshue.
 Shpejt xhandart e kanë rrethue.
 N'gjygi Hasimja paska shkue.
 N'istintak gjygi po e qet —
 ja shtoi burgun për tetë vjet.
- 200 Hiç Hasimja s'po ka dert,
 ka luftue për ftyrë të vet,
 shkon n'hapsane tuj folë tuj keshë.
 Prap n'hapsane e kanë ngujue.
 Nis Hasimja me kuvendue:
- 205 -- A ka shiptar qi din me shkrue?
 Hoxhë Visoka aty â qillue.
 — Fol, bre motër, çka po thue?
 — Ti ni letër me ma shkrue,
 Lilë Begracës me ja çue —
- 210 s'ish kânë burrë, as s'ish kânë grue!
 Nizet vjet gjygi m'i dha mue.
 N'paça ymër ni herë me dalë,
 Bell Mavriqin s'e lâ pa e marrë!

Mark Krasniqi

SUR LES TRACES D'UNE CHANSON POPULAIRE

— La chanson de Hasime —

R é s u m é

L'une des chansons populaires les plus répandues au Kosovo, est sans doute celle qui raconte dans les années 1925 les bravoures extraordinaires d'une femme albanaise du village de Mirash, situé aux environs de Prishtinë. L'héroïne de cette chanson se nomme Hasime. C'était une veuve très pauvre qui vivait avec ses frères Ali et Shaban sur un lopin de terre que leur avait donné leur oncle. Pour aider sa famille Ali partit au service militaire à la place d'un paysan riche, qui lui offrit pour cela une certaine somme d'argent. Cela se passait sous l'occupation turque. Ali partit à la guerre et fut fait prisonnier pendant plusieurs années. En rentrant chez lui, il demanda au riche paysan de le dédommager des années perdues comme prisonnier. Le paysan refusa sa demande et le conflit commence.

Alors, un paysan nommé Xhuma tua Ali, puis prit le maquis. Shaban le frère d'Ali essaya de le venger, mais il fut lui aussi tué à son tour dans une bagarre par Xhuma. Hasime se retrouva seule et pensa à la vengeance de ses frères. Elle trouva une solution, épouser une personne qui puisse venger ses frères et pour cela elle offrit son lopin de terre. Lilë Begraca se présenta et promit à Hasime de satisfaire sa demande. Mais deux années passèrent et „Lilë de son fusil n'a pas tiré”

Finalement Lilë convoqua le meurtrier des frères de Hasime pour tenter une réconciliation. Hasime apprenant la trahison de son mari, décida de se venger seule. Elle se déguisa en homme, prit un revolver et partit pour Mirash chercher Xhuma, mais elle ne le trouva pas. Selon une vieille coutume

populaire, on peut se venger sur une autre personne de la famille si le responsable est absent. Aussi trouvant l'oncle de Xhuma, Hasime te tua, Hasime fut condamnée à 12 ans d'emprisonnement par le tribunal de Ferizaj et envoyée à la prison de Nish.

En prison, elle fut attaquée par un sous-officier de garde qui voulut la violer. Pour se défendre Hasime le frappa d'un bac plein d'eau et le tua. Bien sûr, elle fut condamnée de nouveau. Tel est le contenu de cette chanson.

Le poète populaire représente Hasime avec des qualités extraordinaires comme une femme albanaise fière et décidée, alors qu'à cette époque la femme au Kosovo était très arriérée, soumise aux préjugés religieux et à son mari. Elle ne sortait pas dans la rue sans cacher son visage d'un foulard noir. Alors que l'attitude de Hasime ne pouvait à cette époque n'être qu'une attitude d'homme. Même devant les tribunaux elle s'est comportée comme une héroïne, son seul désir était de rentrer pour tuer Lilë son mari, qui l'avait trahi en voulant se réconcilier avec l'assassin de ses frères. Selon la chanson populaire, au second procès, Hasime a eu un comportement courageux et fier, car elle s'est de nouveau attachée à défendre son honneur.

La chanson de Hasime a quelques variantes. La plus complète jusqu'à maintenant était celle que l'auteur de ces lignes avait noté en 1939 dans le village de Gllaviçicë près de Pejë et qu'il avait publié en 1954 dans la revue littéraire „Jeta e Re” à Prishtinë.

Plus tard, en 1959, il a eu l'occasion de noter, une nouvelle variante, plus complète, chantée par Sadri Mehmeti, du village de Janosh, qu'on publie à cette occasion.

La chanson de Hasime, comme les autres chansons de preux sont chantées et accompagnées d'instruments populaires connus, comme par exemple la „qifteli” qui est un instrument à deux cordes. L'expression poétique et la musicalité des vers de la chanson de Hasime sont des exemples de la plus belle création populaire de ce genre. En plus, son contenu très intéressant et très rare, ses qualités artistiques, font que cette chanson est toujours écoutée avec plaisir dans tout le Kosovo.

